



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“BUJQËSI”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-H-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	6
NjN-08-IV-0286-25 Planifikimi, organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-08-IV-0287-25 Menaxhimi i fermës bujqësore.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-08-IV-0288-25 Menaxhimi i fermës blegtorale dhe akuakulturës	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-08-IV-0289-25 Menaxhimi i fermës organike	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-08-IV-0290-25 Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.....	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
NjN-08-IV-0291-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në bujqësi	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	20
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse.....	21
Modalitetet e vlerësimit	21
Informacion shtesë	22
SHËNIM	22

Emërtimi i kualifikimit	BUJQËSI			Kodi
Kohëzgjatja	1500 orë nocionale	Niveli	Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	K-H-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “BUJQËSI”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher të mesëm në sektorin e bujqësisë për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bujqësor/blegtoral apo për krijimin e menaxhimit të një ferme bujqësore/blegtorale private.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional në “BUJQËSI” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, në kualifikimin profesional “BUJQËSI”; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “BUJQËSI”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher i mesëm në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ferma bujqësore/blegtorale, si dhe institucione të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në sektorin e bujqësisë si teknik, menaxher i mesëm. Gjithashtu, individë mund të vetëpunësohen në sektorin e bujqësisë në kuadrin e një biznesi individual në fushën e bujqësisë. Me përfundimin e këtij niveli, individë ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, si dhe pajiset me Certifikatën e teknikut/menaxherit të ekonomive bujqësore. Me përfundimin e këtij niveli, individë ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet mëparshme	H-III-15; H-IV-20			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional **“Bujqësi”**, **niveli IV në KSHK**, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim dhe me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
10. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
11. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
12. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
13. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
14. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
15. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
16. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
17. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
18. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
19. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-08-IV-0286-25 Planifikimi, organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë sektorët dhe nënsektorët në bujqësi;
2. Të shpjegojë elementët e planit të prodhimit të fermës;
3. Të argumentojë rëndësinë e planifikimit dhe organizimit të aktivitetit bujqësor;
4. Të shpjegojë llojet e proceseve të punës në fermë;
5. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës në fermë;
6. Të shpjegojë procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
7. Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të burimeve materiale;
8. Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të burimeve financiare;
9. Të shpjegojë metodat e sigurimit të burimeve materiale dhe financiare;
10. Të shpjegojë përdorimin e materialeve dhe funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
11. Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave të punës në fermë;
12. Të shpjegojë mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë të bujqësisë;
13. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së realizimit të detyrave në fermë dhe rëndësinë e tyre;
14. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit dhe monitorimit të sistemit dhe pastrimit të vendit të punës;
15. Të shpjegojë format e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
16. Të shpjegojë metodat e kontrollit dhe monitorimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve bujqësore;
17. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së kontrollit të gatishmërisë për punë të bazës materiale, mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore;
18. Të analizojë rezultatin e fermës bujqësore;
19. Të argumentojë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve digjitale për menaxhimin e fermës;
20. Të shpjegojë formatet e dokumentimit të punës;
21. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit për punën e kryer.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të planifikojë dhe organizojë punën për realizimin e veprimtarive në fermën bujqësore;
2. Të menaxhojë burimet materiale dhe njerëzore për realizimin e proceseve të punës;
3. Të kryejë veprime të blerjeve dhe shitjeve të produkteve bujqësore;
4. Të dokumentojë dhe raportojë për punën e kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen planifikimin e punës sipas prioriteteve në bujqësi;

- Përcakton proceset e punës sipas teknologjisë së kultivimit;
- Monitoron zbatimin e detyrave sipas radhës së punës;
- Planifikon radhën e punës sipas proceseve;
- Planifikon saktë kohën e punës;
- Planifikon burimet njerëzore sipas proceseve të punës dhe nevojave të sektorit;
- Përzgjedh burimet njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimeve përkatëse;
- Planifikon burimet materiale dhe financiare sipas planit të prodhimit;
- Siguron burimet materiale dhe financiare sipas planit të prodhimit;
- Ndan detyrat në ekip sipas kualifikimeve përkatëse;
- Bashkëpunon me specialistë të tjerë sipas rregullores së brendshme dhe proceseve të punës;
- Mbikëqyr realizimin e detyrave sipas planit të prodhimit;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve bujqësore sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr kontrollin e gatishmërisë së bazës materiale sipas proceseve të punës dhe manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Dokumenton kryerjen e veprimeve të blerjeve dhe shitjeve, sipas procedurës përkatëse;
- Përdor teknologjinë digjitale në menaxhimin e fermës sipas manualeve të përdorimit;
- Dokumenton punën e kryer sipas formateve përkatëse;
- Raporton tek eprori për realizimin e detyrave në mënyrë periodike sipas rregullores së brendshme.

NjN-08-IV-0287-25 Menaxhimi i fermës bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë domosdoshmërinë e monitorimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të tokës;
2. Të shpjegojë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ndërtimit të brezareve në tokat e pjerrëta;
3. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së sistemit të kullimit dhe ujitjes;
4. Të shpjegojë mënyrat e përdorimit të mjeteve për mbikëqyrjen e sistemit dhe përgatitjes së tokës;
5. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të sistemit dhe përgatitjes së tokës;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të mbjelljes së kulturave bujqësore;
7. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së shërbimeve agroteknike në kulturat bujqësore;
8. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të pjekjes së prodhimit;
9. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të vjeljes së prodhimit;
10. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit të prodhimit;

11. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të transportimit të prodhimit;
12. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të seleksionimit të prodhimit;
13. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit të prodhimit;
14. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të ruajtjes së prodhimit;
15. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së teknologjive të prodhimit në mjedise të mbrojtura;
16. Të argumentojë rëndësinë ekonomike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve pa tokë;
17. Të shpjegojë teknologjitë e prodhimit në sistemet e kultivimit pa tokë;
18. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së teknologjive të prodhimit në sistemet e kultivimit pa tokë;
19. Të shpjegojë rëndësinë ekonomike dhe mjekësore të kultivimit të kërpudhave;
20. Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit, përgatitjes dhe tregtimit të kërpudhave;
21. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së teknologjive të prodhimit të kërpudhave;
22. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së kryerjes së analizave klimatiko - tokësore;
23. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së bimëve të kopshtarisë/hapësirave të gjelbërta;
24. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve dekorative të kopshteve/hapësirave të gjelbërta;
25. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të krijimit të tapeteve të barit dhe mureve të gjelbërta;
26. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së teknikave të prodhimit të fidanëve të bimëve zbukuruese/dekorative;
27. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së përgatitjes së tokës dhe mbjelljes së farave/fidanëve;
28. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së shërbimeve agroteknike pas mbjelljes së farave dhe fidanëve;
29. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të krasitjes dekorative të bimëve të kopshtit;
30. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve teknologjike të kultivimit të bimëve të kopshtit në mjediset e mbrojtura;
31. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të marrjes dhe përgatitjes së produkteve përfundimtare të kopshtarisë;
32. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të seleksionimit, ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve të kopshtarisë;
33. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të magazinimit dhe të ruajtjes së produkteve të kopshtarisë;
34. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë digjitale në menaxhimin e fermës bujqësore;
35. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së përdorimit të platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit bujqësor;
36. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve digjitale për kontrollin digjital të kushteve të ruajtjes së

prodhimeve/produkteve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e teknikave të sistemimit dhe kullimit të tokave;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e teknologjive të kultivimit të kulturave bujqësore;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e teknologjive të kultivimit të bimëve kopshtare;
4. Të mbikëqyrë zbatimin e teknologjive digjitale në menaxhimin e fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit

- Monitoron zbatimin e teknikave të sistemimit të tokës sipas procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të ndërtimit të brezareve në tokat e pjerrëta sipas kërkesave dhe kushteve teknike;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të sistemit të kullimit dhe ujitjes sipas kërkesave dhe kushteve teknike;
- Kontrollon funksionimin e mjeteve për sistemimin dhe përgatitjen e tokës për mbjellje sipas manualeve përkatëse;
- Monitoron përdorimin e mjeteve për sistemimin dhe përgatitjen e tokës për mbjellje sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të proceseve të sistemimit dhe përgatitjes së tokës për mbjellje sipas kërkesave teknike përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të mbjelljes së kulturave bujqësore sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e kryerjes së shërbimeve agroteknike në kulturat bujqësore sipas teknikave përkatëse;
- Monitoron procesin e pjekjes së prodhimit sipas destinacionit të përdorimit;
- Monitoron zbatimin e procesit të vjeljes së prodhimit sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr grumbullimin e prodhimit sipas kërkesave teknike;
- Mbikëqyr transportimin e prodhimit sipas kërkesave teknike dhe destinacionit;
- Mbikëqyr seleksionimin e prodhimit sipas kërkesave dhe destinacionit të përdorimit;
- Kontrollon procesin e magazinimit të prodhimit sipas kushteve teknike të kërkuara;
- Mbikëqyr mënyrat e ruajtjes së prodhimit sipas kushteve teknike të kërkuara;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjive të prodhimit në mjedise të mbrojtura sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjive të prodhimit në sistemet e kultivimit të bimëve me substrat sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të kultivimit të bimëve me hidroponi sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të kultivimit të bimëve me aeroponi sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të kultivimit me akuaponi sipas standardeve përkatëse;

- Mbikëqyr zbatimin e teknologjise së kultivimit të kërpudhave sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e metodave të kryerjes së analizave klimatiko - tokësore sipas teknikave përkatëse;
- Monitoron përzgjedhjen e bimëve të kopshtarisë sipas kushteve klimatiko - tokësore të zonës;
- Mbikëqyr zbatimin e projekteve dekorative të kopshteve sipas kushteve teknike të projektit;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të krijimit të tapeteve të barit dhe mureve të gjelbërta sipas kushteve teknike të projektit;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjive të prodhimit të fidanëve të bimëve zbukuruese dhe dekorative sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të përgatitjes së tokës dhe mbjelljen e farave/fidanëve sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e kryerjes së shërbimeve agroteknike pas mbjelljes së farave dhe fidanëve sipas mënyrave e teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr proceset e krasitjes dekorative të bimëve të kopshtit sipas mënyrave e teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të kultivimit të bimëve të kopshtit në mjediset e mbrojtura sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të procesit të marrjes dhe përgatitjes së produkteve përfundimtare të kopshtarisë sipas kërkesave dhe destinacionit të përdorimit;
- Mbikëqyr proceset e seleksionimit, ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve të kopshtarisë sipas kërkesave dhe destinacionit të përdorimit;
- Mbikëqyr magazinimin dhe ruajtjen e produkteve të kopshtarisë sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjisë digjitale në menaxhimin e fermës bujqësore sipas katalogëve përkatës;
- Përdor platformat, mjetet, pajisjet dhe aplikacionet digjitale në proceset e prodhimit bujqësor sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet për kontrollin digjital të kushteve të ruajtjes së prodhimeve/ produkteve sipas manualeve përkatëse.

NjN-08-IV-0288-25 Menaxhimi i fermës blegtorale dhe akuakulturës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbarështimin dhe rritjen e kafshëve;
2. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të vendstrehimit;
3. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve higjieno - sanitare të fermës blegtorale;
4. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së gjendjes shëndetësore dhe mirëmbajtjes së kafshëve dhe shpendëve;

5. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së procesit të ushqyerjes së kafshëve dhe shpendëve;
6. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së procesit të riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve;
7. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së trajtimit veterinar të kafshëve dhe shpendëve;
8. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit të prodhimit të kafshëve dhe shpendëve;
9. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të transportit dhe magazinimit të prodhimit blegtoral;
10. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së kushteve të ruajtjes së prodhimit blegtoral;
11. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes së bletëve;
12. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes së kategorive të veçanta (krimbi i mëndafshit, kërmilli etj.);
13. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të baseneve dhe rezervateve;
14. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve higjieno - sanitare të baseneve dhe rezervateve;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes së peshkut;
16. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ushqyerjes së peshkut;
17. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të riprodhimit të peshkut;
18. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së përkujdesjes shëndetësore të peshkut gjatë rritjes;
19. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit dhe transportimit të peshkut;
20. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit të peshkut;
21. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ruajtjes së peshkut;
22. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të rritjes së specieve të tjera (midhje, karkaleca etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë mënyrat dhe teknikat e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve;
2. Të mbikëqyrë mënyrat dhe teknikat e rritjes së bletëve;
3. Të mbikëqyrë mënyrat dhe teknikat e rritjes së peshkut;
4. Të mbikëqyrë mënyrat dhe teknikat e procesit të rritjes së specieve të tjera (midhje, karkaleca etj.).

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr përgatitjen e infrastrukturës së fermës dhe vendstrehimeve për kafshët dhe shpendët sipas standardeve;
- Mbikëqyr zbatimin e kushteve higjieno - sanitare në fermë sipas standardeve;
- Kontrollon gjendjen shëndetësore të kafshëve dhe shpendëve në momentin e ardhjes në fermë sipas procedurës;
- Mbikëqyr procesin e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve sipas standardeve;
- Mbikëqyr periodikisht procesin e riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve;

- Kontrollon periodikisht zbatimin e kalendarit të vaksinimeve dhe trajtimeve parandaluese;
- Monitoron periodikisht zbatimin e masave për kafshët dhe shpendët të prekur nga sëmundjet sipas rregullores;
- Mbikëqyr procesin e grumbullimit të prodhimeve blegtorale (qumësht, mish, vezë, etj.) sipas standardeve përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimeve blegtorale sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr transportin e prodhimeve blegtorale sipas kushteve teknike;
- Kontrollon magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve blegtorale sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr rritjen e bletëve dhe prodhimit të mjaltit sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr rritjen e kategorive të veçanta (krimi i mëndafshit, kërmilli, etj.) sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr rritjen e specieve ujore si midhje, karkaleca, etj. sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr përgatitjen e infrastrukturës së baseneve dhe rezervateve ujore për rritjen e peshkut dhe specieve të tjera sipas standardeve;
- Mbikëqyr kushtet e rritjes së peshkut dhe specieve ujore sipas teknikave;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të ushqyerjes së peshkut dhe specieve të tjera sipas standardeve;
- Mbikëqyr zbatimin e teknikave të riprodhimit të peshkut dhe specieve të tjera ujore sipas standardeve;
- Mbikëqyr grumbullimin e peshkut dhe specieve të tjera ujore sipas teknikave përkatëse;
- Kontrollon transportin e peshkut nga baseni në magazinë sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr magazinimin e peshkut dhe produkteve ujore sipas kushteve teknike.

NjN-08-IV-0289-25 Menaxhimi i fermës organike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e bujqësisë organike, përfitimet shëndetësore, ekologjike, ekonomike dhe social - kulturore;
2. Të shpjegojë rëndësinë e burimeve natyrore të bujqësisë organike (tokë, ujë, ajër, etj.);
3. Të shpjegojë mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri;
4. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre;
5. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të mjeteve për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e tokës në kultivimin organik;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së analizimit të cilësive biologjike të tokës dhe ujit;
7. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së treguesve për vlerësimin e biodiversitetit në fermën organike;
8. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së teknikave të punimeve minimale;

9. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së llojeve të plehrave në plehërimin organik;
10. Të shpjegojë metodat e mbikëqyrjes së përdorimit të plehrave organike, minerale dhe lëndëve shtesë të lejuar në bujqësinë organike;
11. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes për përzgjedhjen e farave/fidanëve në bujqësinë organike;
12. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të mbjelljes së kulturave në kultivimin organik;
13. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së shërbimeve agroteknike në kultivimin organik;
14. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së përdorimit të preparateve të lejuara dhe kontrollin biologjik për mbrojtjen e bimëve;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të pjekjes/vjeljes në kultivimin organik;
16. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit, seleksionimit dhe transportimit të prodhimeve organike bimore;
17. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit dhe ruajtjes të prodhimeve organike bimore;
18. Të shpjegojë praktikatat e mbarështimit të kafshëve në fermën organike;
19. Të shpjegojë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së mbarështimit organik të kafshëve dhe akuakulturës organike;
20. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të vendstrehimit të kafshëve dhe shpendëve në mbarështimin organik;
21. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve higjieno - sanitare të fermës blegtorale në mbarështimin organik;
22. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së mirëqenies ekologjike dhe gjendjes shëndetësore/veterinare të kafshëve dhe shpendëve;
23. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ushqyerjes dhe riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve në mbarështimin organik;
24. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit dhe transportimit të prodhimit organik të kafshëve dhe shpendëve;
25. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të magazinimit dhe ruajtjes së prodhimeve organike blegtorale;
26. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të prodhimit organik në akuakulturë;
27. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimeve organike bimore dhe blegtorale;
28. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të kontrollit dhe etiketimit në bujqësinë organike;
29. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit bujqësor organik.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e teknologjive të prodhimit, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimeve organike bimore;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e teknologjive të prodhimit, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimeve organike blegtorale;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të prodhimit organik, magazinimit dhe ruajtjes në akuakulturë;
4. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të kontrollit të prodhimit, ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale organike.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr përgatitjen dhe mirëmbajtjen e tokës në kultivimin organik sipas llojit të kulturës;
- Mbikëqyr cilësitë biologjike të tokës në kultivimin organik sipas metodave dhe teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr cilësinë e ujit në kultivimin organik sipas standardeve;
- Mbikëqyr nivelin e biodiversitetit në fermën organike sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr plehërimin bazë/plotësues të tokës me plehra organike dhe minerale të lejuara sipas kërkesave të kulturave;
- Mbikëqyr përdorimin e lëndëve shtesë të lejuara në bujqësinë organike sipas rregullave të përcaktuara;
- Mbikëqyr përzgjedhjen e farave/fidanëve me prejardhje organike sipas rregullave të përcaktuara;
- Mbikëqyr proceset e mbjelljes së kulturave në kultivimin organik sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e shërbimeve agroteknike në kultivimin organik sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr përdorimin e preparateve të lejuara sipas rregullave të përcaktuara;
- Monitoron kontrollin biologjik për mbrojtjen e bimëve sipas rregullave të përcaktuara;
- Mbikëqyr proceset e pjekjes në kultivimin organik sipas llojit të kulturave;
- Mbikëqyr proceset e grumbullimit, seleksionimit dhe transportit të prodhimeve organike bimore sipas standardeve;
- Mbikëqyr proceset e magazinimit dhe ruajtjes të prodhimeve organike bimore sipas standardeve;
- Mbikëqyr kushtet e vendstrehimit të kafshëve dhe shpendëve në mbarështimin organik sipas rregullave përkatëse;
- Mbikëqyr kushtet higjieno - sanitare të fermës blegtorale në mbarështimin organik sipas standardeve;
- Mbikëqyr mirëqenien ekologjike dhe gjendjen shëndetësore/veterinare të kafshëve dhe shpendëve sipas rregullave të përcaktuara;
- Mbikëqyr procesin e ushqyerjes dhe riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve në

- mbarështimin organik sipas ciklit jetësor të tyre dhe rregullave të përcaktuara;
- Mbikëqyr proceset e grumbullimit dhe transportit të prodhimit organik të kafshëve dhe shpendëve sipas standardeve;
- Mbikëqyr magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve organike blegtorale sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të prodhimit organik në akuakulturë;
- Mbikëqyr proceset e ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale organike duke përdorur ambalazhe ekologjike sipas standardeve;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të kontrollit dhe etiketimit në bujqësinë organike;
- Mbikëqyr përzgjedhjen dhe përdorimin e platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit bujqësor organik sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr përzgjedhjen dhe përdorimin e pajisjeve për kontrollin digjital të kushteve të ruajtjes së prodhimeve bujqësore organike sipas manualeve përkatëse.

NjN-08-IV-0290-25 Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi që lidhet me cilësinë e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;
2. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve ndërkombëtare për cilësinë e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale (ISO, Global GAP, HACCP etj.);
3. Të shpjegojë zbatimin e metodologjive për vlerësimin e cilësisë të proceseve prodhuese bujqësore dhe blegtorale;
4. Të shpjegojë kriteret dhe teknikat që përdoren për vlerësimin e cilësisë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;
5. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të bimëve të arave;
6. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të perimeve;
7. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të drurëve frutorë;
8. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të bimëve aromatike dhe mjekësore;
9. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të qumështit;
10. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të vezëve;
11. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të mishit;
12. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave;
13. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të mjaltit;
14. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së prodhimit të fijes së mëndafshit;
15. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të kushteve teknike që duhen për ruajtjen e cilësisë së produkteve bujqësore e blegtorale;
16. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve për cilësinë e ujit që përdoret në fermë

sipas destinacionit të përdorimit;

17. Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të cilësisë në mjediset e fermës;

18. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit digjital të shërbimeve bujqësore dhe blegtorale.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të bimëve të arave, perimeve, drurëve frutorë, bimëve aromatike dhe mjekësore;
2. Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të qumështit, mishit, vezëve, etj.;
3. Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të peshkut, midhjeve, karkalecave, etj.;
4. Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon cilësinë e prodhimit të bimëve të arave sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të perimeve sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të drurëve frutorë sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të bimëve aromatike dhe mjekësore sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të qumështit sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të vezëve sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të mishit sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të mjaltit sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Kontrollon cilësinë e prodhimit të fijes së mëndafshit sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së bujqësisë;
2. Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
3. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
4. Të shpjegojë mënyrat e monitorimit të regjistrimit të të dhënave për faturat dhe mënyra e përgatitjes së një oferte;
5. Të shpjegojë llojet e raportimeve;
6. Të argumentojë rëndësinë e raportimit tek eprori;
7. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e informimit nga tregu lidhur me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
8. Të shpjegojë procedurat e hartimit të inventarit dhe bilancit të një ferme bujqësore;
9. Të argumentojë regjistrimin e veprimeve ekonomike që realizohen në fermë;

10. Të shpjegojë konceptet e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndikimin e tyre në kapitalin e fermës;
11. Të argumentojë funksionimin e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në fermë;
12. Të argumentojë shlyerjen e detyrimit ndaj shtetit për TVSH-në;
13. Të shpjegojë procedurën e hartimit të bilancit përfundimtar të fermës;
14. Të argumentojë domosdoshmërinë e analizës dhe vlerësimit të mbylljes vjetore;
15. Të analizojë riskun dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre;
16. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
17. Të shpjegojë llojet e faturave dhe mënyrat e plotësimit të tyre;
18. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktin/shërbimin që do të ofrojë;
19. Të shpjegojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
20. Të shpjegojë elementet e llogaritjes së çmimit përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara;
21. Të shpjegojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e produkteve/shërbimeve dhe mënyrat e përgatitjes së tyre;
22. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të teknikave të marketingut bujqësor;
23. Të shpjegojë mënyrat e analizimit të vetvetes dhe metodat e zhvillimit profesional;
24. Të shpjegojë teknikat e motivimit, të orientimit dhe zhvillimit për karrierë të punonjësve;
25. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve;
26. Të shpjegojë mënyrat e identifikimit të nevojave për trajnim të stafit;
27. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjive bashkëkohore për proceset e punës në bujqësi;
28. Të shpjegojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
29. Të argumentojë rëndësinë e studimit të literaturës bashkëkohore;
30. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
31. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në trajnime dhe kurse teknike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë kodin e punës dhe legjislacionin tatimor në fuqi;
2. Të kryejë veprime financiare;
3. Të zbatojë teknikat e marketingut për produktet/shërbimet e kryera;
4. Të monitorojë procedurat e zhvillimit profesional të stafit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me korrektësi legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin lidhur me aktivitetin që kryen;
- Plotëson planet ditore, javore, mujore të punës, sipas detyrave dhe llojit të punimeve në bujqësi;
- Dokumenton punën e kryer, konsumimin e materialeve dhe urdhrat e punës sipas formateve përkatëse;

- Monitoron regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara klientëve sipas procedurave përkatëse;
- Përgatit raporte për aktivitetet e zbatuara sipas formateve përkatëse;
- Siguron rregullisht informacione nga tregu lidhur me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve sipas nevojave përkatëse;
- Mbikëqyr hartimin e inventarit dhe bilancit të një ferme bujqësore sipas procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr shlyerjen e detyrimit ndaj shtetit për TVSH-në sipas legjislacionit përkatës;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve të kryera sipas procedurave përkatëse;
- Përgatit saktë oferta për produktet/shërbimet që do të ofrojnë referuar çmimeve aktuale të tregut sipas llojit të produktit/shërbimit;
- Kryen blerje të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme sipas nevojave dhe standardeve në fushën e bujqësisë;
- Llogarit saktë çmimin përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara bazuar në kostot dhe çmimeve të tregut;
- Plotëson procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të porosisë te klienti për produktet/shërbimet e shitura sipas afateve të përcaktuara;
- Plotëson dhe ruan dokumentacionin financiar, sipas procedurës dhe formateve përkatëse;
- Zbaton teknikat e duhura të marketingut për produktet/shërbimet që ofrohen sipas rregullave;
- Monitoron procedurat e zhvillimit profesional të punonjësve sipas kritereve përkatëse;
- Përdor metoda motivuese dhe të orientimit në karrierë të punonjësve sipas performancës në punë;
- Vlerëson performancën e punonjësve në punë sipas formateve të përcaktuara;
- Monitoron pjesëmarrjen në trajnime dhe kurse të ndryshme sipas nevojës për kualifikim të vazhdueshëm të stafit.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë metodat e informimit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë rregullat e komunikimit etik dhe profesional;
3. Të shpjegojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal dhe përdorimit të gjuhës së trupit;
4. Të argumentojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një komunikim;
5. Të argumentojë rëndësinë e marrjes dhe përcjelljes së mesazheve të qarta në një komunikim;
6. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të punës në grup;
7. Të shpjegojë metodat e zgjidhjes së problemeve, mosmarrëveshjeve dhe mendimi kritik në mjedisin e punës;
8. Të shpjegojë rregullat e komunikimit me bashkëpunëtorët në veprimtarinë profesionale;

9. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
10. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në komunikimin me të tjerët;
11. Të argumentojë rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit në veprimtarinë profesionale;
12. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj., në komunikim.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të komunikojë me etikë profesionale me klientët dhe bashkëpunëtorët;
2. Të zbatojë teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
3. Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj., në komunikim.

Kriteret e vlerësimit

- Informohet periodikisht me problemet dhe të rejat e ditës sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në planin e punës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit etik dhe profesional sipas Kodit të Etikës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit verbal dhe jo verbal dhe përdorimit të gjuhës së trupit sipas rregullit;
- Përdor terminologjinë profesionale në mjedisin e punës, sipas rregullores së brendshme;
- Dëgjon në mënyrë aktive dhe të vëmendshme në një komunikim, sipas rregullit;
- Merr dhe përcjell mesazhe të qarta në komunikim, sipas rregulloreve përkatëse;
- Monitoron zbatimin e parimeve të punës në grup, sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr zgjidhjen e problemeve, mosmarrëveshjeve dhe mendimit kritik në mjedisin e punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit me bashkëpunëtorët në veprimtarinë profesionale sipas rregullores së brendshme;
- Përdor teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit sipas rregulloreve përkatëse;
- Siguron ruajtjen e konfidencialitetit në veprimtarinë profesionale sipas rregullores së brendshme;
- Respekton barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj., në komunikim sipas kodit të etikës.

NjN-08-IV-0291-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në bujqësi

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe legjislacionit në fuqi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të manualeve të mjeteve dhe

pajisjeve të punës;

3. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe mjetet përkatëse;
4. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së respektimit të sinjalistikës në mjedisin e punës;
5. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
6. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve të MZSH3;
7. Të argumentojë rëndësinë e marrjes së masave në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
8. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike;
9. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të vendosjes së tabelave të sigurisë teknike dhe rrethimit të objektit;
10. Të shpjegojë mënyrat e përdorimit të produkteve dezinfektuese, deratizuese dhe dezinfektuese;
11. Të shpjegojë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga mbetjet bujqësore e blegtorale;
12. Të shpjegojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
13. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e mjedisit dhe standardeve ekologjike;
14. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së ndarjes së mbetjeve sipas llojit;
15. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së depozitimit të mbetjeve;
16. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së ruajtjes dhe magazinimit të materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit në përputhje me rregulloret e miratuara;
17. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit me efikasitet të burimeve;
18. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve dhe legjislacionit në fuqi për rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave për mbrojtjen e mjedisit dhe depozitimit të mbetjeve organike nga aktiviteti bujqësor;
3. Të mbikëqyrë përdorimin në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurimin teknik;
- Mbikëqyr zbatimin e manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas rastit;
- Mbikëqyr dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti sipas rastit;
- Mbikëqyr respektimin e sinjalistikës (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës sipas

³Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

sektorëve të prodhimit;

- Zbaton procedurat e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës përkatëse;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas procedurës përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e masave gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e masave në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave të duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit referuar rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr përdorimin racional të energjisë dhe materialeve dhe zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit sipas rregulloreve përkatëse;
- Kontrollon rrethimin e objektit dhe tabelat e sigurisë teknike sipas rregullave përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e protokolleve të duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi, organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi	20	NjN-08-IV-0286-25
2	Menaxhimi i fermës bujqësore	17	NjN-08-IV-0287-25
3	Menaxhimi i fermës blegtorale dhe akuakulturës	16	NjN-08-IV-0288-25
4	Menaxhimi i fermës organike	13	NjN-08-IV-0289-25
5	Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale	7	NjN-08-IV-0290-25
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	13	NjN-23-IV-0005-24
7	Komunikimi etik dhe profesional	7	NjN-22-IV-0006-24
8	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në bujqësi	7	NjN-08-IV-0291-25
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësitë e të nxënit specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-H-IV-25**

K - Kualifikim

H – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

IV – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-08-IV-0286-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

08 – Numri që identifikon fushën e Njësive të të Nxënit

IV – Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0286 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit